




KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË

SKUPŠTINA OPŠTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



PROCESVERBAL I/2026

I mbajtur me rastin e mbledhjes së I (parë) për vitin 2026 të Komitetit për
Komunitete Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 27.01.2026
Ora : 09:00

Prezentë:

Z. Shkendije Shabanj-Kryesuese

z.Nazim Shabanaj

znj.Merita Basha

z.Zek Berisha

znj.Amira Sofra

z.Aziz Bytyqi

z.Urim Suka

Të pranishëm tjerë:

Xheladin Sadikaj- Zyrtar për Kthim dhe Komunitete

Habibe Bytyqi - Zyrtare për barazi gjinore

Zyra për informim

Përfaqësues i OSBE-së

Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Nazim Shabanaj cili propozoi këtë:

Rend Dite

1.Zgjedhja e Kryesuesit të Komitetit për Komunitete;

2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e të hyrave e të dalurave të Buxhetit të Komunës së Suharekës për vitin 2026;

Nazim Shabanaj-e hedhë në votim rendin e ditës

Unanimisht miratohet

Avni Bytyqi-përshendetje për të gjithë,ju dëshirojë punë të mbarë dhe suksese për këtë komitet,po besojë materialin e keni marrë me kohe dhe pasi me propozoj anëtari me i vjetër i komitetit pika e

parë është zgjedhja e Kryesuesit të komiteti për komunitete,për arsye se thot ligji për qeverisje lokale dhe udhëzimi administrativ për përbërjen e komiteteve obligative dhe qe themelohen nga kuvendi i punës këtë rast Suharekës eobligon komitetin për komunitete nga radhët e veta ta zgjedhë Kryesuesin e Komitetit për Komunitete nga radhët e komitetit pakicë dhe kërkojë të propozohen njëri nga anëtarët e komitetit pakicë për Kryesues.

Zek Berisha-përshendetje për të gjithë,unë nga komiteti Rom propozoj Shkendije Shabanaj.

Nazim Shabanaj-unë nga komiteti Ashkali propozojë Shkendije Shabanaj

Shkendije Shabanaj-përshendetje për të gjithë,unë propozojë Zek Berisha

Avni Bytyqi- e hedhë në votim

Me 6 vota për **Shkendije Shabanaj** zgjedhet Kryesuese e Komitetit për Komunitete

Kryesuesja-faleminderit për zgjedhjen,po besojë që kemi me kalu mirë për këto 4 vite.

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e të hyrave e të dalurave të Buxhetit të Komunës së Suharekës për vitin 2026;

Kryesuesja- e elaboron pikën dhe hap debatin.

Avni Bytyqi-këtu është edhe Zyrtari Kryesor Financiar i cili e ka përgadit dhe hartu këtë projekt-buxhet në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës dhe me Ekzekutivin e kalum,nëse keni ndonjë pyetje mundeni me parashtru.

Kryesuesja-kam vetëm një pyetje,lidhur me zyrën për komunitete dhe kthim,mema sqaru një gjë se ne ndoshta nuk jemi shumë në rrjedha kësaj ndarje të buxhetit dhe si shpenzohen,është një vlerë kogja e ulët për zyrën për komunitete dhe kthim,kur këto mjete ndahen për shpenzime administrative të zyres apo për nevojat që i përkasin Komuniteteve pakicë?

Fadil Hoxha-përshendetje për të gjithë,krahasuar me vitin 2025 buxheti është 2.17% më i lartë se në 2025,pyetja juaj konkrete tek programi i komunitetev kjo është pjesë vetëm për nevojat e Zyrës që ndahet këto 2000€ nga të hyrat vetanake,ndërsa për nevojat tjera është pjesa e buxhetit shtesë që Kryetari ka mundësi me nda si subvencione ose pjesë të ndryshme nëse komuniteti ka nevojë për diqka.

Urim Suka-përshendetje për të gjithë,së pari ju urojë për zgjedhjen,ju urojë të na shkojë një mandat i mbarë,ajo që deshta me thënë,unë e kam lexu materialin dhe kam shumë vrejte për mënyrën se si është përgadit buxheti por shumicën e tyre unë do ti themë të Premtën në Asamble me qëllimin e vetëm nese ka mundësi ky dokument të përmirësohet me ato vrejtjet që janë.Gjatë leximit që kam pa,në krahasim me herën e kaluar nese nuk gabojë kam pa që në disa vendbanime ka një shkurtim buxhetor nëse jam i qartë në fshatin Bllacë ka qenë 80.000€ tash është 70.000€, a mundem me ditë pse ka ndodhë ky shkurtim buxhetor dhe e dyta është një numer i konsiderueshëm i rrugëve për vitin 2026 që parashihen të ndertohen në fshatin Bllacë mirpo buxheti është 70.000€ dhe është i shkurtuar,dhe po mendoj a e keni planifiku që ky buxhet a është i mjaftueshëm për qato rrugë që janë planifiku,kur po e permendi fshatin Bllacë po e permendi vetëm si referencë sepse ksi shkurtime kam pa edhe nëvendbanime tjera dhe dua një sqarim pse ka ndodhë?

Fadil Hoxha-krahasuar me buxhetin që nuk ka kalu në Shtator,janë disa ndryshime diku deri në 7-8% të ndryshimev dhe janë prek një pjesë e madhe e projekteve kapitale dikun 3-4% si mesatare,Kryetari ka vendosë me bë një projekt të ri,psht 250.000€ ndërtimi i objektit për zjarrëfikës në Shirokë ky projekt nuk ka qenë në projekt-buxhetin e 30 Shtatorit që nuk është aprovu ky projekt është shpërnda dhe jan tërhek nga projektet tjera kapitale.

Kryesuesja- e hedhë në votim pikën 2

6 për 1 kundër miratohet për Asamble